



Telekomi i Kosovës SHA përfaqësuar në mënyrë të ligjshme nga z. Agron Mustafa, Drejtor Menaxhues, në njërin anë ("Telekomi"),

dhe

Dardafon.net LLC përfaqësuar në mënyrë të ligjshme nga z. Milot Gjilolli, Drejtor Menaxhues i Dardafon.net LLC, në anën tjetër ("Dardafon")


Lidhin në Prishtinë më datën 24.05.2017 këtë:

#### Marrëveshje

për ekzekutimin e vendimit final të arbitrazhit i nr. 20990/MHM, datës 09.12.2016

#### Definicionet:

|                         |                                                                                                                                                                                                                      |
|-------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| BID                     | nënkupton Bordin e Drejtorëve të Telekomit                                                                                                                                                                           |
| MSA                     | nënkupton Marrëveshjen për Mbështetje e lidhur ne mes të PTK Sh.a., NRB 70280741 dhe Daradfon.net LLC, e datës 16 Janar 2009.                                                                                        |
| MTI                     | nënkupton, Monaco Telecom International.                                                                                                                                                                             |
| Vendimi i Arbitrazhit   | nënkupton Vendimi Tribunalit të Arbitrazhit ndërkombëtar sipas rregullave të ICC me numër 20990/MHM i datës 09.12.2016                                                                                               |
| Tribunali i Arbitrazhit | nënkupton Tribunalin e Arbitrazhit të themeluar sipas Rregullave të Odes Ndërkombëtarë Tregtare (ICC) me seli në Paris, i themeluar sipas nenit 16.7 të MSA përmes palëve, i cili ka nxjerrë Vendimin e Arbitrazhit. |



SA

118

Arbitrazhi

MNO

Gjykata e Lartë e Londrës

Arbitrazhi dhe MNO

nënshkruan këtë marrëveshje për ekzekutimin e Vendimit të Arbitrazhit

nënshkruan Operatorin e Telefonisë Mobile Telekom

nënshkruan gjykatën e Londrës "High Court of Justice, Queen's Branch Division Commercial Court"

## MARRËVESHJE

### PËR EKZEKUTIMIN E VENDIMIT FINAL TË ARBITRAZHIT I NR. 20990/MHM, dt.09.12.2016

#### A. Duke e marr parasysh se:

- Palët kanë të nënshkruar marrëveshjen MSA-në të datës 16 Janar 2016, e cila aktualisht është në fuqi;
- Gjatë implementimit të kontratës kanë lindur konteste lidhur me implementimin e kontratës, për të cilat Dardafon ka iniciuar procedurën e arbitrazhit sipas padisë së datës 13.04.2015;
- Me datë 09.12.2016, **Tribunal i Arbitrazhit** ndërkombëtar sipas rregullave të ICC ka nxer vendim me nr. 20990/MHM datës 09.12.2016 ("Vendimi i Arbitrazhit"), i cili është bërë final **ndërkombëtarisht**;
- Telekomit ka konsumuar mjete ligjore për kontestimin/anulimin e Vendimit të Arbitrazhit ndërkombëtar pranë Gjykatës së Lartë të Londrës, e cila e ka refuzuar kërkesën e Telekomit;
- Telekomit ka iniciuar procedurat pranë gjykatave nacionale të Republikës së Kosovës për kontestimin e Vendimit të Arbitrazhit;
- Dardafon është në fazën e procedurës së iniciuar të njohjes dhe ekzekutimit të vendimit;
- Telekomit në datën e nënshkrimit të kësaj marrëveshje, nuk është në gjendje financiare që të paguan përmbush obligimet financiare bazë që dalin nga Vendimi e të cilat obligime në datën 17.05.2017 kapin shumën rreth 32 milion Euro (kalkulim intern nga palët jo obligative për palët në proceset tjera);
- Dardafoni është në fazën kritike të operimit me kërcënim të falimentimit të kompanisë si dhe hapjen e procesit të ri legal në arbitrazh kundër Telekomit, nëse Telekomit refuzon/vonon zbatimin e Vendimit;
- Telekomit është duke operuar pa Bord të Drejtorëve që nga data 28.12.2016 dhe Menaxhmenti duke vepruar konform obligimeve të besuara nga neni 18 i Statutit të korporatës dhe obligimit nga neni 186 i Ligjit për shoqëritë tregtare (Ligji nr. 02/L-123) nën bindjen se është duke vepruar në masë të arsyeshme në interesin më të mirë të

- *Pezullimin e efekteve negative anësore për palët të mosëkzekutimit të vendimit final të arbitrazhit dhe vonësive kohore në operacionet legale; pezullimin e ekzekutimit ndërkombëtar të ekzekutimit të Vendimit të Arbitrazhit*
- *Vazhdimin e bashkëpunimit komercial mes paleve dhe zbatimin e MSA. Respektimin pa kurrfarë lufizimi ose kushtëzimi të marrëveshjes bazë të MSA datës 10.01.2009, konform interpretimeve obligative nga vendimi final i arbitrazhit ndërkombëtar. Gjetjen e modaliteteve bazë të mirëkuptimit të paleve për lehtësimin e ekzekutimit të vendimit të arbitrazhit me synimin kryesor respektimin e pikave a. dhe b. lartë të kësaj marrëveshjeje. Mënjanimin e rrezikut që Telekomit të bllokohet në operacione nga veprimi (eventual dhe i mundshëm) i inicuar i Dardafon për përmbarrim të vendimit final të arbitrazhit.*

Neni 1  
Shërbimet 3G/4LTE

Aktivizon konsumatorëve të Dardafon pa vonësë shërbimet e kërkuara 3G dhe 4G/LTE, sipas Nenit 2.4.1 të MSA, pa limitim ose kufizimi dhe shërbimeve tjera sipas zhvillimeve teknologjike.

Neni 2  
Numerazioni

Fillimisht alokon pa vonesë bllokun e lirë (80,000 deri 90,000 numra) të numeracionit 0457XXXXX, sipas Nenit 2.6.1 të marrëveshjes MSA, duke mos përfshiruar alokimin e numeracionit shtesë, pas implementimit të numeracionit të ri të kodit shtetëror telefonik të Kosovës;

Neni 3

Kompensimi i shpenzimeve te Arbitrazhit

3.1. Telekomit i paguan Dardafonit shumën totale prej 4,500,000.00 EUR në emër të kompensimit të shpenzimeve të të gjitha procedurave juridike, zhvilluar pranë Tribunalit të Arbitrazhit sipas rregullave të ICC sipas afateve të mposhtme:

3.2. Për shprehim të Dardafon janë të argumentuara dhe dëshmues në dokumentacion relevant mbështetës.

#### Neni 4 Validiteti i kontratës

4.1. MSA e lidhur mes palëve më 16.01.2009, mbetet në fuqi dhe konsiderohet e pandryshuar, paprekur dhe obligative për palët.

4.2. Me qëllim të implementimit të nenit 3 të kësaj Marrëveshjeje, Telekom i zotohet për zgjatjen e validitetit të MSA edhe pas datës 30 Korrik 2019 me rastin e rinovimit të licencës për MNO, në çka edhe është e bazuar MSA bazë, me kushte të njëjta dhe pa kumfarë ndryshimi deri në datën 31.12.2023. Gjashtë muaj para datës së skadimit të kësaj date, palët duhet të tihen në mirëbesim për vazhdimin e kontratës për kohëzgjatjen e licencës së re të MNO, ashtu sikur parashihet me nenit 3.1 të MSA.

#### Neni 5 Pezullimi i përkohshëm i ndarjes së të hyrave

5.1. Telekom do të hjekë dorë nga inkasimi i të hyrave prej 27% sipas aneksit nr. 2 të MSA deri më 31.12.2023, duke përfshirë edhe vitin fiskal 2016, për të cilin vit, tani më Dardafon në mënyrë ligjore e ka ekzekutuar kompozimin.

5.2. Shpenzimet (kostot) direkte për shërbimet e pranuar paguhen nga Dardafon konform MSA në fuqi duke shtuar këtu koston e shijes së data në roaming, pas paraqitjes së kostove në mënyrë transparente nga Telekom për Klientët e Dardafon.

#### Neni 6 Koordinimi dhe bashkëpunimi për zbatimin e Marrëveshjes

6.1. Telekom i zbaton pa hezitim të gjitha dispozitat e kontratës bazë të marrëveshjes MSA.

6.2. Telekom i siguron dhe të mos zbatoj asnjë kufizime të kapaciteteve dhe kualitetit të shërbimeve të destinuara për Dardafon (Z-mobile):

6.3. Palët zotohen në koordinim të shtuar të aktiviteteve rreth implementimit të pakushtëzuar të të gjitha dispozitave të MSA dhe Vendimit të arbitrazhit, duke nënkuptuar posaçërisht po duke mos u kufizuar:

#### Neni 7 Koordinimi në aspektet teknike

Palët kanë ra dakord si vijon:



shkruar

konferencat veshkuese të cilat mbahen në mënyrë të rregullt dhe 40 (të dhjetë) ditë informacione mbi

- iii) përfundimi për mbulueshmeri shtetë në lidhje me tërësit e shërbimeve (p.sh. përfundim ose llojve të reja) të Dardafonit në lloje të barabarta sikur për klientët e Telekomit.
- iv) Përkrahja për zhvillimin e Dardafonit në Full MVNO dhe ofrimi i shërbimeve të domosdoshme për shërbime sipas kushteve të arsyeshme, tërësisht në komizat e MSA në fuqi por minimalisht sipas modeleve të rishmë të kontraktuara. Dardafon do të vendosë se cilat shërbime do të lëkohen pas ngritjes në platformën Full MVNO.
- v) Koordinim dhe respektim i plotë në projektin e implementimit të kodit +383, MNC MCC 221 06 sipas vendimit të ARKEP nr. 955; dhe
- vi) SLA për përkrahje teknike dhe shërbimeve të reja

Neni 8

### Marrëveshjet juridike

8.1. Pa paragjykuar çështjet juridike të palëve të parashtruara pranë gjykatave në procedurë ekzistuese, me qëllim të implementimit të kësaj Marrëveshjeje në interes dypalësh, palët janë dakorduar që:

- i) Dardafon pajtohet që të hejë dorë nga procedura e iniciuar e njohjes dhe ekzekutimit të vendimit final të arbitrazhit 20990/MHM datës 09.12.2016, duke tërhequr propozimin për njohjen e Vendimit të Arbitrazhit të datës 07.03.2017;
- ii) Telekom pajtohet të hejë dorë nga padia e iniciuar për anulim të vendimit, duke tërhequr propozimin për anulimin e Vendimit të Arbitrazhit, të datës 19.01.2017

8.2. Telekom, duke e marrë parasysh statusin e të qenurit kompani publike dhe realitetin se në momentin e nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje për zbatimin e Vendimit të Arbitrazhit, operon pa Bord të Drejtorëve ("BiD"), kjo Marrëveshjeje pas emërimit të BiD nga Aksionari brenda periudhës 6 muajore kalendarike pas emërimit të BiD nga Aksionari dhe funksionalizimit të punës së tij, Telekom në mënyrë të njëanshme mund të vendosë që të tërhiqet nga kjo Marrëveshjeje. Me këtë rast, do të konsiderohet se kjo Marrëveshjeje nuk ka ekzistuar dhe Telekom pranon kthimin në situatën nga vendimi final i arbitrazhit 20990/MHM datës 09.12.2016, ndërsa obligimet eventuale të kryera/paguara nga Telekom deri në atë kohë si respektim i kësaj marrëveshjeje, do të kalkulohen në mënyrën dhe kuptimin e ekzekutimit të dispozitave bazë të vendimit final të arbitrazhit 20990/MHM datës 09.12.2016. Pas kalimit të afatit 6 muajor, Telekom nuk mund të zbatojë të drejtën e tyre për tërheqjen nga kjo Marrëveshjeje.

8.3. Telekom pajtohet se në rastin e dështimit të përbushjes së obligimeve të saj nga pika 1-6, Dardafon mund të shkëpusë këtë marrëveshjeje dhe automatikisht hynë në fuqi dispozitat e vendimit final 20990/MHM datës 09.12.2016, me ç'rast Dardafon do të mund të ri-iniciojë procedurat e njohjes dhe ekzekutimit të Vendimit të Arbitrazhit ose të iniciojë procedurat për ekzekutimin e kësaj Marrëveshjeje. Për evitimin e çfarëdo keqkuptimi, palët ka ra dakord që e drejta e iniciimit të procedurës së njohjes nuk parashkruhet deri me 31.12.2023 dhe Telekom hejë dorë nga kundërshtimi i parashkrimit në procedurë për njohje dhe ekzekutim të vendimit, nëse kjo kontratë shkëputet para ekzekutimit të detyrimeve të Telekom-it.

SEKRET AFARIST

Shumë konfidencial

...vendimin final të arbitrazhit ndërkombëtar 20990/MHM datës 09.12.2016. Kjo nuk vlen, nëse Telekomi tërhiqet nga kjo Marrëveshje sipas nenit 8.2 ose në njëra shtëputet për shkak të mos-përbashkimit të saj nga ana e Telekomit.

#### Neni 9

#### Dispozitat përfundimtare

9.1. Kjo marrëveshje paraqet vullnet të lirë të palëve dhe ky dokument ka karakterin e sekretit afarist i cili nuk mund të i publikohet palëve të treta pa lejen eksplicite me shkrim të palës tjetër ose në mënyrën e përcaktuar me ligjet pozitive në fuqi.

9.2. Dardafon dhe Telekomu dakordohen edhe për këto veprime që do të garantojnë dhe siguronin mbarrëvajtjen e raportit komercial nga MSA dhe ekzekutimi i kësaj Marrëveshje mireduptimi:


- Themelimin e komisionit miks 4 anëtarësh për përcjellje të raportit dhe në baza ditore të intervenimit në eliminimin e pengesave dhe/ose mos marrëveshjeve. Në rastin e mosmarrëveshjes rreth dispozitave të kësaj marrëveshje të mireduptimi palët me vullnet dhe iniciativë mundën të angazhojnë ekspertiza adekuate për ti ndihmuar ato në tejkalim të situatës
- Asnjë dispozitë e kësaj marrëveshje mireduptimi nuk do të konsiderohet si ndryshim ose modifikim i dispozitave të kontratës bazë MSA, por këtë dokument të marrëveshjes do ta interpreton, kupton dhe ekzekuton ekskluzivisht si pajtim të lirë në ekzekutimin me vullnet të vendimit final të arbitrazhit nr. 20990/MHM datës 09.12.2016.
- Do të respektohen pa kurrarë kushtëzimi dhe pa insistuar në efekt eventuale të kësaj marrëveshje të gjitha vendimet e organeve shtetërore, gjyqësore që në ndërkohë do të mund sillnin në këtë rast.
- Negocimet si dhe zgjedhjet eventuale të reja të dakorduara në ndërkohë mes palëve në MSA do të kenë efektin e tyre në dispozitat realizuese të kësaj marrëveshje të mireduptimi.

Ndryshimet dhe korrigjimet eventuale në dispozitat e kësaj marrëveshje të mireduptimi mundën të ndodhin vetëm me pajtim të dyanshëm të palëve dhe me aneks me shkrim i cili do të konsiderohet pjesë përbërëse e kësaj marrëveshje të mireduptimi.

9.3. Kjo marrëveshje mes palëve të nënshkruhet dhe do të jetë valide me nënshkrim. E njëjta do noterizohet tek noteri i autorizuar brenda afatit prej 7 ditëve nga data e nënshkrimit.

9.4. Palët kuptojnë se kjo marrëveshje ka fuqinë e aktit të përbashkët dhe mund të ekzekutohet pa zhvillimin e procedurave kontestimore.

9.5. Marrëveshja e mireduptimit është nënshkruar në 2 ekzemplar identik në gjuhën shqipe, për nevojë të palëve në proces.




*[Handwritten signature]*

*[Handwritten signature]*

Agj. Agion Mustafaj  
Pozita: Drejtor Menaxhues

Data: 24.05.  
2017



Emri: Z. Edlir Gjilic  
Pozita: Drejtor Menaxhues

Data: 24.05.2017



Handwritten signature.